

Programi i shkencave natyrore

A dëshiron të vazhdosh studimet pas gjimnazit?
A dëshiron të keshë baza sa më të gjëra që t'i aftësosh ato?
A dëshiron të keshë një mundësi të punosh dhe të studijosh jashtë vendit?
A dëshiron të analizosh, të eksperimentosh dhe të laborosh?
A dëshiron të mësosh më tepër në lidhje me çështje që janë aktuale te debatet shoqërore?
Në atë rast, Programi i shkencave natyrore mund të jetë për ty.

Nga perspektivat e shkencave natyrore të jepet mundësia që të analizosh, vlerësosh dhe të mbajshë qëndrime për çështje që kanë të bëjnë me shoqërinë por edhe me individin. Mund të ketë të bëjë me për shembull çështje për zhvillim të qëndrueshëm apo për shëndetin. Gjatë kualifikimit do të keshë mundësi që të diskutosh mbi pyetje të parashtruara etike, si për shembull eksperimentet me kafshë dhe për kushtet jetësore të njeriut. Puna eksperimentale është një pjesë e rëndësishme e kualifikimit. Mund të ketë të bëjë me observime, eksperimente, eksperimente laboratorike dhe studime të terrenit. Në disa raste, nxënësit vetë mund të zgjedhin mënyrat e veprimit, në rast e tjera instruksionet janë më të detajuara.

Programi i shkencave natyrore të jep një kualifikim të gjërë që përveç lëndëve të shkencave natyrore dhe matematikës, poashtu përmban edhe lëndë të shkencave shoqërore dhe humane. Zhvillimi i diturive gjuhësore është një pjesë e rëndësishme për kualifikimin.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Programi i shkencave natyrore të përgatit për vazhdim studimesh. Pas gjimnazit do të keshë kompetence që të kërkosh të pranohesh te kualifikimet në fakultet dhe univesitet. Mund të zgjedhësh t'i vazhdosh studimet në për shembull shkencat natyrore, matematikë, medicinë apo në teknik.

Punë ku mund të pranohesh

Varrësisht nga ajo që e zgjedh të studijosh pas gjimnazit, mund të kërkosh punë në shumë lëmi në ardhmëri.

Përmbajtja e Programit

Programi i shkencave natyrore përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programin e shkencave natyrore. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej tre drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin e shkencave natyrore në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimit. Në disa shkolla gjimnazi mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimit kombëtare janë:

- Matematikë dhe shkencat kompjuteristike – për ty që dëshiron të mësosh më tepër për matematikë, shkencat kompjuteristike dhe teknologji të informacionit.
- Shkencat e ambientit – për ty që ke një interesim të veçantë për resurset ambientale dhe natyrale dhe që do të studijosh zhvillimin e shoqërisë nga perspektivat ekologjike, sociale dhe ekonomike
- Shkencat natyrore – për ty që dëshiron të thellohesh te pjesët e shkencave natyrore të kualifikimit dhe që dëshiron të studijosh më tepër fizikë, kimi dhe biologji.

Kontakte me tregun e punës

Kualifikim në vende të punës (APU) nuk është pjesë e Programit të shkencave natyrore, por mund të ketë mundësi për ty që të të caktojnë një apo disa vende pune gjatë kohës së gjimnazit. Kjo varret nga drejtimi që e ke zgjedhur.

Ardhmëri dhe punë

Shumica e kualifikimeve në universitete dhe fakultete të japin mundësi të mira që të punësohesh në ardhmëri. Tash për tash, për shembull tregu i punës ka gjasa të mira për profesione me drejtime teknike, në IT edhe për mjekë dhe dentist. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se si cilat janë gjasat në lëminë që të intereson ty.